



**Raport nga vlerësimi i Modelit Nansen për arsim interkulturore
në SHFK "Goce Dellçev" Gostivar,
për hulumtimin e realizuar nga prof. dr. Hana Saliu**

shkurt, 2019

RAPORT

Shoqëritë multikulturore janë shoqëritë, në të cilat dominojnë kultura dhe gjuhë të llojllojshme, shoqëri të pasura në të cilat gjithnjë ka diçka për të mësuar. Shoqëritë e tilla japin mundësi për zhvillim edhe të shoqërisë edhe të individit, që lind, zhvillohet dhe jeton në mjedisin multikulturor. Edhe Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend, në të cilin llojllojshmëria e kulturave dhe gjuhëve është e shpërndarë në çdo cep të shtetit. Duke u nisur nga ky fakt, ekip i Nansenit e ka zhvilluar një model për arsim ndërkulturor, me qëllim që multikulturaliteti, i cili mbizotëron në vendin tonë të përdoret për zhvillim pozitiv të gjeneratave të reja. Modeli Nansen për arsim ndërkulturor për dhjetë vite me radhë punon në zhvillimin e modelit të vetë, i cili është i zgjeruar dhe zbatohet në më shumë shkolla në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku mësimi zhvillohet në dy ose tre gjuhë.

Aktivitetet të cilat i zbaton Modeli Nansen për arsim ndërkulturor nëpër shkollat modele të Republikës së Maqedonisë së Veriut realizohen në kuadër të aktivitetet jashtëmësimore. Në kuadër të këtij projekti është zbatuar një hulumtim me qëllim që të mbikëqyrret, nëse aktivitetet për arsim ndërkulturor zbatohen sipas planit të paraparë. Gjatë mbikëqyrjes i është kushtuar vëmendje, nëse qëllimet e përcaktuara të Modelit Nansen zbatohen në praktikë. Disa prej atyre qëllimeve janë: zhvillimi i shkathtësive të reja; pasurimi dhe përvetësimi i diturive të reja; ndërtimi i vetëbesimit dhe promovimi i komunikimit; socializimi (shoqërimi); dialogu; toleranca dhe tejkalimi i stereotipave dhe paragjytimeve; zgjidhja e problemeve; kreativiteti; si dhe mendimi kritik. Hulumtimi është realizuar në shkollën fillore “Goce Delçev” në Gostivar pas realizimit pesëvjeçar të Modelit Nansen për arsim ndërkulturor. Qëllimi kryesor i hulumtimit është: *Vlerësimi i realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore sipas Modelit Nansen për arsim të integruar në pajtim me qëllimet e përkufizuara globale.* Për këtë qëllim Sh.F.K “Goce Delçev” në Gostivar, e cila është shkolla e parë, në të cilën ka filluar të realizohet Modeli Nansen, u realizua një observim i 11 çifteve (tandemëve), të cilat zbatojnë aktivitete jashtëmësimore. Nga mbikëqyrjet e realizuara, 8 janë zbatuar në mësim klasor, ndërsa 3 në atë lëndor. Mbikëqyrjet janë realizuar në periudhë 3 mujore, duke filluar nga tetori deri në dhjetor. Gjatë observimit i është kushtuar vëmendje përmbushjes së qëllimeve globale të parashtruara nga Modeli Nansen për arsim ndërkulturor.

Aktivitetet e mbikëqyra janë realizuar në kuadër të këtyre seksioneve: tre kanë qenë Eko-seksione të realizuara me nxënës të klasës së tretë, një seksion ishte në temën *Njihe Maqedoninë*, i cili është realizuar me nxënës të klasës së dytë dhe të tretë; aktivitete në kuadër të seksionit *Paqe dhe tolerancë* janë realizuar në dy çifte të klasës së katërt; një seksion i mbikëqyrur ka qenë *Konstruktorë*

të vegjël me nxënës të klasës së katërt; një Seksion dramatik i realizuar me nxënës të klasës së dytë; tre çifte të mësimit lëndor kanë pasur seksione me aktivitete të nxënësve përmes sportit dhe muzikës.

Në vendin tonë nuk i jepet rëndësi dhe aspak nuk i kushtohet vëmendje ambientit, në të cilin realizohet mësim dhe mundësohet zhvillimi kognitiv, emocional, social dhe personal i fëmijëve tanë, gjë që paraqet element të rëndësishëm nga aspekti psikologjik. Shumica e klasave të shkollave të vendit tonë janë të pajisurave vetëm me mjetet më elementare (dërrasa, banka dhe karrige), andaj nuk duken si ambiente, në të cilat fëmijët do të ndjehen të rehatshëm dhe të relaksuar, gjegjësisht ato nuk janë mjedise në të cilat do të mund të nxitet zhvillimi i kreativitetit dhe mendimit kritik të nxënësit. Furnizimi i pamjaftueshëm i klasave ndikon në produktivitetin, përkushtimin e vëmendjes dhe aspektet emocionale të nxënësve. Për dallim nga shumica e shkollave në vendin tonë klasat në Sh.F.K “Goce Delçev” në Gostivar iu ngjanë klasave të vendeve të zhvilluara. Ato janë të pajisura me mjete të ndryshme didaktike, të domosdoshme për punë në arsimore dhe edukative të fëmijëve, të cilët duhet të aftësohen të jetojnë në shekullin e 21. Këto mjete didaktike iu ndihmojnë arsimtarëve që së bashku me fëmijët të bëjnë punime të ndryshme në tema të ndryshme. Punimet në fjalë janë të ekspozuara në muret e klasave në dy gjuhët, në të cilat zhvillohet mësimi. Çdo çift para hyrjes në klasë e kishte të vendosur simbolin e çiftit, varësisht nga seksioni i zgjedhur, ndërsa secili nxënës ishte i prezantuar me emër. E njëjta vlen edhe për arsimtarët e çiftit. Muret e klasës ishin të stolitura me punimet e fëmijëve në të dy klasat. Kuptohet punimet ishin të bëra në të dy gjuhët. Mësueset, të cilat punonin në çift, bashkëpunonin edhe në kuadër të mësimit të rregullt, ashtu që shumica e punimeve ishin në të njëjtën temë, në të dy gjuhët, në mënyrë që fëmijët të mund të njoftohen me fjalët e gjuhës tjetër. Ekspozimi i përditshëm i fëmijëve ndaj atyre stimulimeve mundëson, që të mësohen informacione dhe fjalë të reja, pa angazhime dhe përpjekje shtesë.

Bankat në klasat, në të cilat realizohen aktivitetet ishin të organizuara për punë grupore. Çdo orë e mbikëqyrur fillonte me ndarjen e nxënësve nëpër grupe. Ndarja në grupe bëhej ose përmes zhetonëve ose përmes tërheqjes së fletëve me ngjyra ose me numra të ndryshëm. Grupet, të cilat për një kohë më të gjatë punonin së bashku, veç më i kishin formuar grupet e përziera për nga karakteri etnik dhe për nga gjinia. Në fakt secili nxënës e dinte grupin e vetë, vendin ku duhej të ulet dhe i njihte mirë shokët, me të cilët bashkëpunonte gjatë secilit aktivitet. Kjo atmosferë ishte në shërbim të shfrytëzimit ekonomik të kohës, ndërsa grupet gjithnjë ishin të përziera për nga përkatësia etnike dhe gjinore, gjë që nganjëherë nuk ndodhte gjatë ndarjes së nxënësve sipas përzgjedhjes së rastit, për shkak se bëhej fjalë për një numër të vogël të nxënësve. Çiftet e arsimtarëve e nxinin punën ekipore varësisht nga aktiviteti i paraparë për atë seksion. Në kuadër të grupeve të formuara kishte aktivitete, të cilat

realizoheshin në mënyrë grupore, në çift ose në bazë individuale, varësisht nga punimet, të cilat duhej të përpunoheshin brenda orës.

Pas ndarjes në grupe secila orë vazhdonte me lojë kreative dhe produktive të sajuar nga arsimtaret, me çka nxënësve iu jepej mundësi të shprehen dhe të zbavitën. Në klasë krijoheshin atmosferë e këndshme, garuese dhe motivuese ndërmjet grupeve të nxënësve, për shkak se lojërat ishin të konceptuara në mënyrë që të ketë një fitues në fund të lojës, gjë që mundësonte që nxënësit më të motivuar të vazhdojnë me aktivitetet vijuese. Këta lojëra iu ndihmonin arsimtareve, t'i drejtojnë nxënësit në mënyrë spontane dhe zbavitëse në temën, që zhvillohet në atë orë. Lojërat e përzgjedhura për të filluar orën përputheshin me temën, e cila duhej të përpunohej gjatë orës. Përdoreshin lojërat: memorie, tërheqje të kafshëve nga barabani, asociacioni, ngrohtë-ftohtë, rebusi etj. Këta lojëra fillestare nuk shërbenin vetëm për zbavitje, por duke luajtur fëmijët e ushtronin dhe përmirësonin kujtesën dhe përvetësonin informacione të reja për tema të ndryshme. Gjatë lojërave çdo nxënës përfshihej në lojë dhe secili bënte angazhim maksimal për të fituar në grupin e vetë.

Mësueset, të cilat punonin në çifte për realizim të këtyre aktiviteteve koordinoheshin mirë dhe plotësonin njëra tjetrën gjatë realizimit të aktiviteteve. Orët realizoheshin në dy gjuhë, ashtu që njëra mësuese fillonte të shpjegojë në njëren gjuhë, pastaj vazhdonte mësuesja tjetër t'i shpjegonte informacionet e njëjta në gjuhën tjetër. Mësueset në të gjitha çiftet ishin të buzëqeshura, të disponuara, bashkëpunonin mes vete, përpiqeshin t'i përgjigjen secilit nxënës pavarësisht nëse është nxënësi i tyre ose nxënës i koleges, që jep përshtypje, se gjatë kohës së realizimit të këtyre aktiviteteve ato kanë qasje individuale ndaj nxënësve, përpiqen t'i aktivizojnë të gjithë nxënësit, iu ndihmojnë atyre gjatë kryerjes së detyrave, nëse një gjë e tillë është e nevojshme, madje ato ishin aktive dhe motivuese gjatë gjithë orës. Ky qëndrim i mësueseve reflektohej në mënyrë pozitive edhe ndaj sjelljes dhe disponimit të nxënësve. Për secilën orë të gjitha çiftet e mbikëqyra kishin plan ditor të punës për aktivitetet, të cilat realizohen gjatë orës.

Në disa orë vazhdonin me diskutim për temën e cila duhej të përpunohej, që të arrihet në mënyrë spontane deri te objektet, të cilat do të përpunohen gjatë orës. Në disa orë tjera vazhdonin me paraqitje të video incizimeve në lidhje me temën, ose me ekspozimin e fëmijëve në muzike ose tinguj varësisht nga lëndët, të cilat duhej të përpunohen si aktivitet. Në këtë kohë fëmijët shumë janë të dhënë pas përdorimit të teknologjisë, madje më shumë u ka ëndja teknologjinë sesa mësimin. Gjatë këtyre orëve ky fakt është përdorë në mënyrë shumë më produktive dhe edukative. Shumica e çifteve përdornin internetin dhe kompjuterin, me qëllim që t'iu ofrojnë nxënësve informacione shtesë për realizim të aktiviteteve, gjë që kontribuoi që fëmijët të kuptojnë se interneti mund të përdoret dhe

duhet të përdoret për mësim. Në shumicën e çifteve gjatë aktivitetit nxënësve iu lëshohej muzikë në lidhje me temën e përpunuar (p.sh. muzikë të vikingëve ose instrumente të ndryshme popullore), ose nëse nuk kishte mundësi që tema të prezantohet me muzikë, atëherë lëshohej muzikë klasike. Kjo ndërhyrje kontribuonte që në klasë të mbizotërojë atmosferë e këndshme, relaksuese dhe motivuese. Me përdorimin e këtyre mjeteve të nxënësit nxitet mbajtja mend e informacioneve auditive dhe vizuale, që është mënyrë më efektive për mësim, sesa pranimi pasiv i informacioneve të dhëna nga mësuesja, siç ka qenë në mësimin klasik. Pra orët nuk ishin sipas metodave klasike të punës, ku arsimtari shpjegon për ndonjë temë, ndërsa nxënësit e dëgjojnë, mirëpo mësueset ishin vetëm simulues ose orientues të aktiviteteve.

Përpos stimulimit vizual dhe auditiv këta orë e kishin për qëllim të zhvillojnë shkathtësi të reja manuale të nxënësve, siç është prerja, ngjitja dhe bashkimi i gjësendeve. Pas zhvillimit të diskutimit për temën e paraparë, të gjitha orët e mbikëqyrura (përpos orët me ushtrime për njohje) vazhduan me parashtrimin e pyetjeve në lidhje me gjësendet, të cilat duhej t'i punonin grupet gjatë orës. Secili nxënës ka mundësi të barabarta ta shpreh mendimin e vetë dhe të përgjigjet në pyetjen e parashtruar. Pasi që nxënësit futen në temën kryesore të orës, në secilin grup në më shumë çifte sipas zgjedhjes së rastit përmes lojës ndahen materiale të ndryshme të përgatitura nga mësueset për përpunim të punimeve, të cilat ishin të parapara në kuadër të temës ditore. Secili grup e kishte për detyrë të përgatisë një gjësend (ndonjëherë në nivel të grupit, ndonjëherë në çifte, ndërsa ndonjëherë në nivel individual). Punimet e përgatitura përputheshin me temën dhe ishin si pjesë përbërëse e saj ose krahasim i asaj që është e duhur dhe jo e duhur (një çift në kuadër të Eko seksionit përgatiti një lum të pastër dhe një lum të ndotur, me qëllim që të shihet dallimi). Krahasimi i gjësendeve të përpunuara dhe identifikimi i lëndëve, të cilat i takojnë dhe e përshkruajnë temën e njëjtë, zhvillojnë te fëmijët aftësi për sintezë, analizë, klasifikim, vlerësim, krahasim dhe shkathtësi të cilat kontribuojnë në zhvillimin e mendimit kritik.

Në shumicën e aktiviteteve nxënësit ishin të nxitur dhe të motivuar nga mësueset, që jo vetëm të angazhohen ta kryejnë detyrën e tyre për atë orë, por edhe gjësendi i përpunuar të duket bukur, gjë që kontribuon te nxënësit të zhvillohet edhe ndjenja për estetikën. Të gjitha punimet e bëra ishin të vendosura dhe të ekspozuara në klasën, ku mësonin fëmijët, ashtu që atmosferë në hapësirë bëhej e ngrohtë, motivuese dhe reprezentative. Nxënësit, të cilët përfundonin me përgatitjen e punimeve të tyre, motivoheshin t'u ndihmojnë nxënësve tjerë (te nxënësit, të cilët për një kohë më të gjatë punonin së bashku, mësueset nuk kishte nevojë t'i udhëzojnë që t'u ndihmojnë shokëve dhe shoqeve, por

nxënësit shkonin vetë t'iu ndihmojnë). Ata lirshëm shkonin të grupet tjera, i mbikëqyrnin dhe iu ofronin ndihmë, nëse iu nevojitej).

Pas përfundimit të përgatitjes së punimeve të parapara në kuadër të aktivitetit për atë orë, secili grup e prezanton detyrën e përpunuar. Pas prezantimit grupi motivohej me duartrokitje nga gjithë klasa dhe me lëvdata nga mësuesja. Nxënësit ndjeheshin të vlerësuar, kreativ, të aftë dhe të rëndësishëm, gjë që vërehej nga komunikimi i tyre joverbal. Secila orë e mbikëqyruar pas prezantimit të punimeve vazhdonte me lojën përfundimtare, ku të gjithë nxënësit merrnin pjesë së bashku. Gjatë asaj kohe nxënësit ishin shumë të disponuar dhe aktivë, ashtu që shpeshherë kërkonin që loja të përsëritet. Nganjëherë lojërat nxitnin edhe frymën garuese të nxënësve, për shkak se në fund të lojës shpallej një fitues në nivel të grupit, ose në një çift ndaheshin shpërblime në varësi nga suksesi i grupeve.

Pas përfundimit të aktiviteteve të gjithë nxënësit së bashku e rregullonin hapësirën, në të cilën punonin. Ata i vendosnin materialet e punës në vendet e duhura, madje të gjitha grupet së bashku pastronin hapësirën, duke u ndihmuar mes grupeve. Kjo nënkupton se gjatë këtyre orëve nxënësit mësojnë edhe për respektimin e të tjerëve, ruajtjen e hapësirës së përbashkët dhe materialeve të përbashkëta mësimore, zhvillimin e shprehisë dhe përgjegjësisë për ruajtje të ambientit të përbashkët.

Edhe pse orët ishin të kufizuara për nga koha, megjithatë për shkak të atmosferës së këndshme emocionale dhe motivuese, e cila mbizotëronte gjatë këtyre aktiviteteve, gjithnjë vazhdohej ora dhe zgjaste më shumë në bazë të kërkesës së vetë nxënësve. Në asnjë moment gjatë këtyre aktiviteteve jashtëmësimore nuk vërehej lodhje ose bezdisje të nxënësit. Ata ishin aktiv dhe me vëmendje të plotë e ndiqnin atë që zhvillohej gjatë orës. Për moshën e fëmijëve të mbikëqyruar kjo nuk ishte ndonjë dukuri e shpeshtë, për shkak se vëmendja e fëmijëve të moshës 8-9 vjeçare është rreth 30-40 minuta, mirëpo gjatë këtyre orëve fëmijët ishin të përqendruar më gjatë nga koha e parapara (deri në 50-55 minuta). Kjo ishte rezultat i mënyrës sesi ishin të organizuara orët. Fakti që secila orë e mbikëqyruar fillonte me lojë hyrëse, vazhdonte me diskutim, pastaj me punë praktike dhe përfundonte me lojë, kontribuonte që fëmijët të mos jenë nën stres dhe ankth, por bënte që të ata të mbizotërojnë emocione pozitive (të duan këta orë, gjegjësisht të marrin pjesë me dëshirë), por edhe të mësojnë informacione dhe shkathtësi të reja pa detyrime. Aktivitetet e realizuara të fëmijët nxitnin mendim kreativ, ndërsa të disa fëmijë orët e mbikëqyruara përmes pyetjeve që kërkonin analiza dhe mendime më të thella nxitej edhe zhvillimi i mendimit kritik të nxënësit.

Në të gjitha çiftet për kryerje të suksesshme të detyrës nevojitej punë ekipore të nxënësve, të cilët punonin në grupin e njëjtë, gjë që nxiste punë ekipore, bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë

ndërmjet tyre. Me punën e nxënësve në grupe zhvillohej kohezioni grupor, ndjenja e përkatësisë, ndjenja e rëndësisë dhe ndjenja e përgjegjësisë.

Në shumicën e orëve të mbikëqyrura mësueset përpiqeshin t'i kushtojnë vëmendje secilit nxënës, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi ta shprehin mendimin tyre, pa mos u frikësuar nga përqeshja dhe paragjykimet. Një gjë e tillë vërehej qartë, meqenëse në klasë mbretëronte një atmosferë e këndshme, ku çdo nxënës kishte mundësi të shprehet, gjë që shpinte drejt rritjes së vetëbesimit dhe vetërespektit të nxënësit. Po ashtu nxënësit ishin të lirë që në çdo moment të parashtronë pyetje, nëse e kishin diçka të paqartë, ose nëse dëshironin të kenë më shumë informacione në lidhje me temën, që prezantohej gjatë orës. Mësueset e të gjitha çifteve ishin të hapura dhe kishin durim që me ton të butë dhe të këndshëm të zërit të përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga nxënësit. Ky qëndrim dhe kjo mënyrë e sjelljes së mësueseve nxit zhvillimin e komunikimit më të mirë në raportin nxënës-mësuese, nxit zhvillimin e vetëbesimit të nxënësve, nxit lirinë e shprehjes, zvogëlimin e frikës nga gabimi dhe përqeshja, tejkalimin e turpit, meqenëse nxënësit për nga natyra janë më introvert dhe nevojitet të bëhen më të hapur dhe më të socializuar.

Mësueset me më shumë përvojë me këto aktivitet, të cilat për një kohë më të gjatë ishin të përfshira në projekt, më shpesh në këto orë i ndërlidhnin informacionet që i mësonin fëmijët, me informacionet që i mësojnë ose i kanë mësuar gjatë mësimit të rregullt. Kjo do të thotë se aktivitetet jashtëmësimore iu ndihmojnë nxënësve edhe për mësime të përmbajtjeve mësimore nga mësimi i rregullt. Në shumicën e orëve në fund jepet informacion kthyes (feedback) për orën, që në fakt paraqet nxitje për nxënësit dhe ndihmesë për të sjellë vendime dhe për ta vlerësuar orën. Një gjë e tillë kontribuon drejt zhvillimit të mendimit kritik të nxënësve, në lidhje me parashtrimin e pyetjeve për tema të caktuara, të cilat ishin përpunuar në kuadër të seksioneve.

Te çiftet më të reja nxënësit komunikonin ndërmjet vetë në mënyrë joverbale ose në gjuhën angleze, ndërsa te çiftet më të vjetra nxënësit veç më i njihnin disa fjalë për të komunikuar mes vete në mënyrë verbale. Kjo na bën me dije edhe një përfitim tjetër të fëmijëve nga pjesëmarrja në këto aktivitete. Ata e mësojnë një gjuhë, me të cilën për çdo ditë janë në kontakt, ashtu që do të mund të kontribuojnë në komunikim më të mirë dhe më të shëndetshëm ndërmjet tyre. Mësimi i gjuhës ka ndikim edhe në zhvillimin e mendimit. Shumë nocione dhe koncepte, të cilat hasen në një të gjuhë, nuk përdoren në gjuhën tjetër. Prandaj mësimi i gjuhëve ua zgjeron fëmijëve diapazonin dhe mënyrën e të mësuarit.

Nga grupet e çifteve të mbikëqyrura, tre sosh ishin nga mësimi klasor. Këto çifte ishin të reja dhe para pak kohësh kishin filluar t'i praktikojnë aktivitetet jashtëmësimore me nxënësit. Për këtë arsye

aktivitetet, të cilat i zhvillonin ishin me karakter informativ. Arsimitarët e përfshirë në këta çifte ishin shumë të motivuar për punë, gjë që reflektohej edhe te nxënësit. Arsimitarët ishin të përgatitur mirë për aktivitet, koordinoheshin mirë mes vete dhe me sukses e implementonin planin e paraparë ditor të aktiviteteve. Meqenëse nxënësit nuk kishin marrë pjesë më herë në këtë lloj të aktiviteteve, i ndiqnin saktë instruksionet e arsimtarëve të tyre dhe ishin shumë më të qetë dhe më të kufizuar në sjelljen e tyre, në raport me nxënësit e mësimit klasor, të cilët lëviznin lirshëm nëpër hapësirë, parashtronin pyetje, ose e shprehnin mendimin e tyre. Kur mbikëqyrej puna e çifteve të grupeve fillestare, mund të shihje më mirë kontributi i aktiviteteve jashtëmësimore të organizuara nga Qendra për Dialog Nansen. Në çiftet e grupeve, të cilat për një kohë më të gjatë ishin të përfshira në këta aktivitete jashtëmësimore vërehej spontanitet më i madh, atmosferë emocionale më pozitive, komunikim më i madh ndërmjet nxënësve (edhe nganjëherë bëhej fjalë për komunikim joverbal), nxënësit ishin më të hapur për pyetje, diskutim dhe komunikim me mësueset dhe shokët e tyre.

Gjatë hulumtimit ishte realizuar edhe intervistë e shkurtër me mësueset dhe arsimtarët, me qëllim që përmes më shumë detajeve të vërehet përfitimi nga këto aktivitete jashtëmësimore. Gjatë intervistave pothuajse të gjithë arsimtarët kanë deklaruar se janë shumë të lumtur nga puna dhe se kënaqen në këto orë, mirëpo e theksuan edhe faktin se përgatitja për këto orë kërkon më shumë mund dhe punë. Secili çift bënte ndarjen e detyrave në lidhje me orën, ashtu që ata maksimalisht ishin të përqendruar dhe efikas në përmbushjen e këtyre aktiviteteve. Ata deklaruan që seminarët e ndjekura në Qendrën Nansen iu japin ide dhe iu ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve edhe në mësimin e rregullt, ashtu që të gjithë u shprehën se me kënaqësi do të merrnin pjesë edhe në seminare dhe punëtori tjera. Njëra nga dobietë e këtij projekti sipas mësueseve ishte fakti që jo vetëm se fëmijët afrohen mes vete dhe njoftohen, por edhe vetë mësueset kanë krijuar afërsi dhe kanë filluar të kontaktojnë mes vete, madje edhe në jetën private. Në një klasë kishte fëmijë, të cilët në fillim nuk kishin marrë pjesë në këto aktivitete, mirëpo pas ca kohësh vetë prindërit e fëmijëve kishin shprehur dëshirë dhe interes që fëmijët e tyre të marrin pjesë në aktivitetet e tilla. Në disa orë, në të cilat mësueseve iu nevojitej ndihmë nga prindërit gjatë kryerjes së aktiviteteve, vetë mësueset deklaruan se prindërit janë në dispozicion për të ndihmuar. Të gjitha këto elemente e potencojnë ndikimin pozitiv të Modelit Nansen për arsim ndërkluturor, andaj ky model duhet të zgjerohet dhe të zbatohet edhe në shkolla tjera multikulturore në vendin tonë.

prof. dr. Hana Saliu